

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzues për tranzicionin për S SH ISO 45001:2018	Kodi DA-IN-017
		Rishikim nr 0 Dt : 15.4.2019
		Faqe 1- 6

Udhëzues për tranzicionin për **ISO/IEC 45001:2018**

Zbatuesit: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikues të sistemeve të menaxhimit

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit

Kontrolloji: Suela Kromidha

Miratoi: Armond HALEBI

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për S SH ISO 45001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-017</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt : 15.4.2019</p> <hr/> <p>Faqe 2- 6</p>
---	---	---

1.QËLLIMI

Ky dokument përshkruan udhëzime për kalimin nga OHSAS 18001: 2007 në S SH ISO/IEC 45001:2018. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë të akredituar nga DPA, organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim. Ky dokument është i vlefshëm deri në datën 11.03.2021

2. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e trupave certifikues që kryejnë certifikim të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në përputhje me këtë standard.

3. PËRGJEGJËSITË

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe si e tille është nën përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e cilësisë së DPA. Është detyrë e Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4. REFERENCA

UDHËZUES I PLANIFIKIMIT TË TRANZICIONIT PËR ISO 45001:2018 (IAF MD 21:2018)

S SH ISO/IEC 17011:2017

Vendimi 15 i IAF i datës 4 Nëntor 2016, Asambleja e përgjithshme e IAF, Indi.

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për S SH ISO 45001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-017</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt : 15.4.2019</p> <hr/> <p>Faqe 3-6</p>
---	---	--

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit S SH ISO/IEC 17011:2017

EA Bashkëpunimi Evropian për Akreditimin
IAF Forum Nderkombëtar i Akreditimit
DPA Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit

6. PËRMBAJTJA

Të përgjithshme

Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit ka vendosur një periudhë tranzitore tre vjecare për kalimin nga OHSAS 18001: 2007 në standardin S SH ISO 45001:2018 duke filluar nga data 12 Mars 2018.

Në përputhje me dokumentin e IAF MD 21: 2018 dhe rezolutën e 15 të IAF, certifikatat e akreditimit të lëshuara sipas OHSAS 18001:2007 nuk janë më të vlefshme pas datës 12 Mars 2021.

Gjithashtu të gjitha certifikatat e certifikimit të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas OHSAS 18001: 2007 janë të vlefshme deri në 11 Mars 2021. Që nga 12 Mars 2021 certifikatat e sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas 18001:2007 nuk janë më të vlefshme.

Në Mars 2018, ISO ka publikuar standardin ISO/ IEC TS 17021-10: "Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për organet që ofrojnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit - Pjesa 10: Kërkesat në lidhje me kompetencën për auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ". Ky standard jep kërkesa shtesë në lidhje me kompetencën e personelit të përfshirë në procesin e auditimit dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe plotëson kërkesat e ISO/IEC 17021-1:2015. DPA do të përdorë këtë standard në kombinim me standardin ISO/IEC 17021-1:2015 për vlerësimin e kompetencës së organeve certifikuese të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për S SH ISO 45001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-017</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt : 15.4.2019</p> <hr/> <p>Faqe 4-6</p>
---	---	--

7. Kërkesa për tranzicionin për organet certifikuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose që do të aplikojnë për akreditim sipas OHSAS 18001:2007.

Për të realizuar një transferim të lehtë drejt standardit S SH ISO 45001:2018, DPA ka vendosur një program të tillë:

DPA ka informuar të gjithë organet certifikuese të akredituara në lidhje me daljen e dokumentit të IAF “Udhëzuesi për Planifikimin e Tranzicionit për ISO 45001:2018” (IAF MD 21:2018), dokumentit IAF MD 22 dhe standardit ISO/IEC TS 17021-10:2018. DPA i ka njoftuar të gjitha organet e akredituara prej saj në përputhje me OHSAS 18001:2007 të marrin masa në lidhje me implementimin e dokumentave të mësipërme.

DPA do të informojë të gjitha organet certifikuese të akredituar prej saj në lidhje me udhëzuesin e DPA për kalimin nga OHSAS 18001:2007 tek standardi SSH ISO 45001:2018.

Të gjithë organet certifikuese të akredituara nga DPA që kanë lëshuar vetëm certifikata të akredituara sipas OHSAS 18001, të paktën një shqyrtim individual i dokumentacionit/rregjistrimeve mund të jetë i mjaftueshëm. Organet certifikuese të akredituara duhet të dërgojnë në DPA dokumentat e mëposhtme:

- Analiza e ndryshimeve ndërmjet standardeve dhe planin për zbatimin e SSH ISO 45001:2018.
- Ndryshimet në procedurat dhe udhëzimet e punës sipas rastit.
- Përditësimet për kriteret e kompetencës dhe proceset e vlerësimit për të gjitha funksionet.
- Dëshmi që auditorët dhe personeli tjetër kanë demonstruar kompetencat e deklaruara.
- Informacion mbi kriteret e përditësuara në lidhje me kompetencë e organit certifikues
- Planin e trajnimeve dhe kopje të materialeve të trajnimit.
- Dëshmi që IAF MD 22 është marrë parasysh.
- Çdo ndryshim i formatit dhe modeleve të raportimit.

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për S SH ISO 45001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-017</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt : 15.4.2019</p> <hr/> <p>Faqe 5-6</p>
---	---	--

- Komunikimi me klientët, duke përfshirë detajet për tranzicionin e të gjithë klientëve nga OHSAS 18001: 2007 në SSH ISO 45001: 2018 (veçanërisht informacioni i dërguar tek klientët dhe cfarë ka bërë organi certifikues).
- Shembull i një certifikate S SH ISO 45001: 2018.
- Për OVK me shumë vendndodhje, dëshmi e zbatimit në të gjithë vendndodhjet.

Gjithashtu organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të akredituara nga DPA duhet të dërgojnë informacion në lidhje me :

- Nr. e certifikatave të lëshuara kundrejt OHSAS 18001
- Nr. e certifikatave të lëshuara kundrejt OHSAS 18001 me simbolin e akreditimit
- Nr. e certifikatave të lëshuara me simbolin e akreditimit brenda territorit të Shqipërisë
- Nr. e certifikatave të lëshuara me simbolin e akreditimit jashtë territorit të Shqipërisë, vendet se ku janë lëshuar respektivisht
- Nr. e auditoreve të trajnuar për SSH ISO 45001:2018
- Nr. i auditeve të kryera në përputhje me S SH ISO 45001:2018
- Nr. i kompanive të certifikuara me S SH ISO 45001:2018

I gjithë ky informacion në gjuhën shqipe duhet të dërgohet zyrtarisht duke filluar nga data 16.04.2019 deri në datën 30.04.2019. Dokumentacioni do të shqyrtohet nga vlerësuesi teknik i cili do të japë rekomandimin për DPA.

Nëse rekomandimi i vlerësuesit teknik është se organi certifikues i akredituar nga DPA plotëson kërkesat e ISO/IEC 17021-1:2015, ISO/IEC TS 17021-10:2018 dhe S SH ISO 45001:2018 atëherë, procedura do të kalojë për vendimmarrje.

Nëse vlerësuesi teknik ka dyshime në lidhje me përputhshmërinë me kërkesat e standardeve ISO/IEC 17021-1:2015, ISO/IEC TS 17021-10:2018 dhe SSH ISO 45001:2018, DPA do të organizojë një vizitë mbikëqyrëse shtese (me qëllim verifikimin e plotësimit të kërkesave).

Shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e vlerësuesit teknik do të llogaritet një ditë pune dhe do të paguhet nga organi certifikues i akredituar.

Vizita mbikëqyrëse shtesë mund të konsistojë vetëm në rishikim shtesë të dokumentacionit ose vlerësim i zyrës ose një vlerësim me dëshmi ose kombinim i tyre. Vizita mbikëqyrëse shtesë do të organizohet në përputhje me procedurën DA-PT-001.

<p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Udhëzues për tranzicionin për S SH ISO 45001:2018</p>	<p>Kodi DA-IN-017</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt : 15.4.2019</p> <hr/> <p>Faqe 6-6</p>
---	---	--

Vizitat mbikëqyrëse shtesë do të zhvillohet brenda periudhës 30 Maj 2019 deri në 30 Korrik 2019.

Për organet certifikuese të akredituara nga DPA që dështojnë në plotësimin e kërkesave të ISO/IEC 17021-1:2015, ISO/IEC TS 17021-10:2018 dhe SSH ISO 45001:2018, DPA do të reduktojë apo pezullojë fushën e akreditimit kundrejt këtij standardi.

Organi certifikues i akredituar ka të drejtë të kërkojë që mbikëqyrja shtesë të zhvillohet së bashku me mbikëqyrjen e rradhës nëse mbikëqyrja e rradhës është planifikuar brenda periudhës 30 Maj 2019 deri në 30 Korrik 2019.

Aplikimet e reja dhe aplikimet për zgjerim sipas S SH ISO 45001:2018 do të pranohen duke filluar nga data 1 Maj 2019. Pas datës 30 Korrik 2019 asnjë aplikim kundrejt OHSAS 18001:2007 nuk do të pranohet. Nëse do të ketë aplikime të reja ose për zgjerim sipas OHSAS 18001:2007 deri në datën 30 Korrik 2019 dhe vizita vlerësuese nuk është kryer deri në 30 Dhjetor 2019, atëherë vizita vlerësuese do të kryhet pas datës 1 Janar 2020 sipas S SH ISO 45001.

Ju informojmë se akreditimi sipas OHSAS 18001:2007 për organet certifikuese të akredituara aktualisht nga DPA do të mbetet i vlefshëm deri në datën 30 Qershor 2020. Pas kalimit të afatit të përcaktuar, asnjë certifikatë akreditimi sipas OHSAS 18001 nuk është më e vlefshme dhe si rrjedhim edhe certifikatat e certifikimit të lëshuara sipas OHSAS 18001:2007 prej këtyre organeve nuk janë më të njohura nga DPA.

Është përgjegjësi e organeve certifikuese njohja me kërkesat e standardit S SH ISO 45001:2018 dhe hartimi i planeve të tranzicionit të certifikimeve të kryera prej tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit do të monitorojw në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e planeve tv tranzicionin të certifikimeve.